



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,
mbajtur më 30.9.2024, e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Faton Zeka (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fikneta Bejtë (LDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Radie Hoxhaj (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Violeta Salihu (LVV), Arbër Limani (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Berat Lahu (LVV), Berna Saraçi (LVV), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Liridon Selmani (PDK), Arbnora Ajeti, (PDK) dhe Muhamet Selmani (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkyetar, Valbona Ajeti, drejtor e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtor e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Florent Maliqi, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donjeta Dragusha, drejore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Lulzim Fushica, drejtor i Drejtorisë së Emergencës dhe Sigurisë, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Sibel Halimi, drejtores e Drejtorisë së Kulturës, Adelina Sahiti, drejtores e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, përfaqësues të KFOR-it, të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili tha se përkëtë mbledhje është paraparë ky

Faqe 1 nga 4

Rend i ditës:

1. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025.

Arsyetimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025, në pikë të shkurtra e paraqiti Valbona Makolli, drejtore. Ajo tha se nga propozim-buxhetin që e kemi paraqitur në mbledhjen e kaluar, sot në këtë propozim- buxhet i kemi bërë disa ndryshime në Drejtorinë e Investimeve Kapitale, që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe sanimin e rrugëve në disa venbanime të zonave rurale, si dhe ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrjetit të kanalizimit në këto zona rurale.

Nora Kelmendi, në emër të Grupit parlamentar, tha se në këtë buxhet ne askund nuk po e shohim vizionin për një zhvillim të qytetit, i cili vizion patjetër duhet të jetë në përputhje me nevojat tona si qytetarë të këtij vendi. Në mbledhjen e kaluar i kemi parashtruar disa pyetje për ekzekutivin, se a janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve dhe cilat projekte kapitale janë të paraqitura bazuar në këto kërkesa, por në këto pyetje nuk kemi marrë asnjë përgjigje, me të vetmen një përgjigje të dhënë nga drejtoresha e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Me këtë nënkuptojmë se ky buxhet është punuar bazuar në dëshira të njerëzve të caktuar partiak të LDK-së dhe të tjerëve me të cilët tanë jeni në koalicion. Është koha e fundit që ju kryetar, bashkë me kabinetin tuaj, të reflektoni, të punoni, sepse ju ka mbetur vetëm edhe 1 vit qeverisje.

Jeta Rafuna, në emër të Grupit parlamentar, tha se ky është një buxhet që është themel për të gjitha projektet e Kryqytetit për vitin e ardhshëm dhe ju bëjë thirrje partive opozitare të zhbllokojmë këtë proces dhe të bashkëpunojmë si Kuvend komunal për qytetarët e Prishtinës, e jo të bllokohet buxheti për interesa partiake e politike. Projektet që realizohen përmes këtij buxheti do t'i gëzojnë të gjithë qytetarët e Prishtinës, pa dallim, prandaj bllokimi i pakuptueshëm rrezikon mirëqenien e qytetarëve të Prishtinës. Lidhja Demokratike e Kosovës në këtë Kuvend komunal edhe në mandatet e kaluara, asnjëherë nuk ka qenë bllokuese e buxhetit edhe kur kemi qenë në opozitë, sepse buxheti i takon gjithë qytetarëve dhe zhvillimit të Prishtinës.

Bahri Gashi, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, tha se këtë propozim- buxhet aleanca e përkrah për miratim.

Gëzim Mehmeti tha se neve sot na është sjellë një vendim i rëndësishëm, një vendim që përcakton se çfarë do të bëhet me qytetin tonë. Mos votimi i buxhetit do ta dëmtojë qytetin dhe qytetarët të cilët na kanë votuar. Mosmiratimi i buxhetit do të thotë ndalimi i projekteve jetike, që kanë të bëjmë me përmirësimin e infrashturës, ndërtimin e shkollave, modernizimin e qendrave të Mjekësisë Familjare, Emergjencë, përmirësimin e transportit publik etj.

Faqe2nga4

Ne jemi këtu për të sigruuar që qyteti të vazhdojë të zhvillohet, që investimet të vazhdojnë dhe qytetarët të mos pësojnë për shkak të konflikteve dhe kundërshtimeve tona politike. E mbështes të ardhmen e fëmijëve tanë, e mbështes përmirësimin e kushteve të mbijetesës për çdo familje në Prishtinë.

Endrit Zabërgja theksoi se ajo çka është e rëndësishme ta diskutojmë, është që në disa momente besoj që nuk duhet ta shohim njëri-tjetrin në bazë të flamujve partiakë, por në bazë të çështjes të cilën po e trajtojmë, çështje që ka të bëjë me investime kapitale, si në ndërtimin e shkollave, çerdheve, si dhe në investime të tjera për qytetarët e Prishtinës, andaj nëasnje mënyrë ne nuk do të duhej të betonoheshim në kërkesa partiake apo debate politike. Vota ime do të jetë pro mbështetjes së buxhetit të planifikuar dhe të prezantuar nga kryetari Rama, në mënyrë që të hapet pastaj dera për realizimin e këtyre projekteve, andaj bëjë thirrje dhe i lus kolegët nga asambleja, që të jemi të ndërgjegjshëm karshi situatës dhe përgjegjësive tona dhe t'i japim epilog pozitiv sot kësaj teme.

Besart Krasniqi tha se në disa drejtori të Komunës, kryesisht në katër drejtori më kryesore të Komunës është ulur buxheti, siç është Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Sportit, Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Bujqësisë. Lidhur me këtë shtoi se edhe në këtë vit pothuajse në 28 fshatrat e Gollakut, ende nuk janë të kyçura në ujësjellës, po ashtu edhe me rrjetin e kanalizimit, me rrugë, me ndriçim dhe mungesë e linjave të autobusëve, kështu që ky buxhet len anash shumë fshatra dhe lagje të Prishtinës.

Feim Osmani theksoi se ky propozim-buxhet që na është sjellë sot për miratim, nuk ka asnje ndryshim nga projektbuxheti i kaluar. Me këtë buxhet shihet se janë të diskriminuara zonat rurale. Ky buxhet për të marrë votën e shumicës së asamblistëve duhet të ndryshojë, duhet të keni parasysh kërkesat e qytetarëve. Kërkojë që qeveria komunale të ketë vëmendje të shtuar, të punojë jashtëzakonisht shpejtë dhe ta përmirësojë këtë propozimbuxhet, i cili do të duhej të kalonte sepse ka shumë punë që e presin Prishtinën dhe që duhet t'i bëjë ky ekzekutiv, prandaj një propozim-buxhet të tillë nuk mund ta votoj.

Sami Borovci tha se duke pasur parasysh diskutimet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, propozoj për një pauzë të shkurtër, ku përfaqësuesit e partive politike me e pa mundësinë e ndryshimit të disa gjërave brenda këtij dokumenti, në mënyrë që ky dokument të kalojë. Qëllimi është që me i diskutuar edhe njëherë këto projekte konkrete edhe me ekzekutivin se çka mundet me u ndryshuar e çka mundet me u lëvizur, edhe si mundemi me procesu sot me votim të këtij dokumenti.

Lidhur me vërejtet dhe pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Krenar Xhaferi, drejtor.

Faqe3nga⁴

Gëzim Sveçla tha se ne nuk mund ta mbështesim ndërtimin dhe zhvillimin e qytetit në këtë formë se si është sjellur ky propozim-buxhet, ku kërkesat e individëve bëhen pjesë e buxhetit. Ne e kemi përkrahur dhe e kemi mbështetur çdo iniciativë që është në të mirën e qytetit. Për këtë buxhet nuk jemi konsultuar fare. Mendojmë se ky buxhet nuk i shërben Prishtinës, është buxhet zgjedhor i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i krijuar nga zyrtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për interesa të tyre partiale dhe për ta shtyrë përpara agjenden zgjedhore, andaj duhet reflektim i thellë dhe i sinqertë, andaj derisa të ndodh një reflektim i tillë, kjo seancë për neve përfundon këtu.

Pas diskutimit të z. Sveçla, GP i LVV-së e braktisën mbledhjen.

Kryesuesi tha se, në mungesë të kuorumin, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe4nga4